



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Raporti
mbi trajtimin e ankesave dhe
sugjerimeve të sipërmarrjes
për muajin tetor 2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në vijim të komunikimit me ju, në rolin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me qëllim përditësimin tuaj mbi punën e bërë gjatë këtij muaji, kam kënaqësinë të ndaj me ju raportin e muajit tetor 2020 si dhe trajtimin e ankesave në kuadër të njoftimeve periodike.

Muaji tetor në institucionin tonë do të përkonte me fjalën kyce “inovacion”. Kjo për shumë arsye, duke filluar që nga lancimi i “Projektligjit për startupet inovative”, një projektligj për të cilin kemi punuar nga viti 2019, në një bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me mbështetjen e projektit EU For Innovation, mbështetur nga Bashkimi Europian. Nisma vjen në mbështetje të zgjidhjes së problemeve që ka hasur ky sektor në përthithjen e investime të huaja, mungesën e zhvillimit të ekosistemeve, të një përkufizimi të saktë, të aksesit në financë, të lehtësive fiskale, të informacionit, bazës ligjore dhe aksesit në tregun vendas, rajonal dhe global.

Duke vazhduar në linjën e startup-eve dhe inovacionit këtë muaj iu bashkova eventit “Uplift Albania – Faza e Bootcamp” që bëri bashkë sipërmarrës të rinj dixhital profesionistë, ekspertë, akademikë drejtues, vendimarrës dhe politikbërës në sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit nga Shqipëria Kosova dhe Maqedonia.

Ndërkohë që teknologjia dhe inovacioni vazhdojnë të zhvillohen në Shqipëri ku tanimë dhe TUMO hapësira me “e re dhe me” kreative ne “ kryeqytet hapi dyert për të gjithë “ fëmijet e moshës 12-18 vjeç , të cilën pata mundësinë ta vizitoja gjatë hapjes së saj. Një

projekt nga AADF dhe Bashkia Tiranë ku çdo muaj, do të mirepresë më shumë se 1000 fëmijë në ambientet pranë Stadiumit Air Albania, me fokus të veçantë në teknologjinë e së ardhmes, do të eksplorojnë dhe zhvillojnë aftësitë e tyre në 8 disiplina të ndryshme.

Dëshiroj të ndaj me ju dhe dy prej eventeve ku u ftova të merrja pjesë si anëtar paneli "Edicioni i IV i Festivalit të Zhvillimit të Qëndrueshëm"- një event i organizuar nga Ambasada Italiane për një nismë të rëndësishme për të rritur ndërgjegjësimin dhe mobilizimin e qytetarëve, brezave të rinj, sipërmarrjeve, shoqatave dhe institucioneve në lidhje me një sfidë globale që ka të bëjë me zhvillimin e qëndrueshëm. Sfida jonë mbetet përfshirja e biznesit si partner në rrugën e përmbushjes së objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm nëpërmjet edukimit dhe rëndësisë së të kuptuarit të kalimit nga ekonomia lineare në ekonominë cirkulare, si dhe mënyrat më të drejta e përfshirëse që duhen ndjekur për ta arritur me sukses.

Eventi tjetër konsiston në hapjen zyrtare të Dhomës Ekonomike të Gruas, së bashku me Ministren Denaj dhe Sekretaren e Përgjithshme të RCC Majlinda Bregu, mes zonjash të nderuara, biznesmene por dhe nga fusha të tjera të jetës. Tashmë do të kemi edhe një tjetër zë të fuqishëm në mbrojtje të interesave të grave sipërmarrëse. Shumë i kënaqur që dhe fusha e biznesit po sheh gjithmonë e më shumë rritje të grave sipërmarrëse.


Në vijim si çdo muaj kemi vijuar me vizitat në ambjentet e bizneseve të ndryshme, duke filluar nga industria prodhuese dhe tek bizneset teknologjike dhe inovatore, për të ndjekur hap pas hapi problematikat e tyre.

Duke shpresuar në vijimin e komunikimit me ju, shpreh bindjen time të thellë se nëpërmjet bashkëpunimit ne mund të përmirësojmë klimën e të bërit biznes në vendin tonë.

Me konsideratën më të lartë,
Eduard Shalsi

Analiza e Ankesave Tetor 2020

1. Statusi i ankesave dhe trajtimi i tyre



2. Statusi dhe shpërndarja e ankesave sipas ministrive

